


DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
- ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT 616/A NIPT L24128601B-

Nr.782/ 3Regj.

Tiranë, më 08.05.2023

URDHËR
(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)Drejtuar: QENDRA KOMBETARE BIZNESIT, TIRANË
BLV.ZHAN DARK TIRANE

Për dijëni: Shoqeria Ujesjellesi Berat-Kuçove Me Nipt J62903166T

"D & A FIN PARTNER" SHPK me Nr. Nipt L01707002Q

Unë, Aurel Mato, përmbarues gjyqësor pranë Zyrë E Përmbarimit Privat 616/A, bazuar në Vendimin Urdhëri ekzekutimit Nr.5268 Dt.17.10,2022 Gjykata Rrethit Gjyqësorë Tirane,

KONSTATOVA:

Se në datë 11.04.2023, është depozituar pranë Zyrë E Përmbarimit Privat 616/A, kërkesa e kreditorit "D & A FIN PARTNER" SHPK me Nr. Nipt L01707002Q, së bashku me titullin ekzekutiv me palë:

Kreditor: "D & A FIN PARTNER" SHPK me Nr. Nipt L01707002Q

Debitor: Shoqeria Ujesjellesi Berat-Kuçove Me Nipt J62903166T

Objekti: Pagim detyrimi +shpenzime gjyqësore

Në kushtet kur afati i ekzekutimit në mënyrë vullnetare ka kaluar, ekzekutimi ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm. Në bazë të ligjit ekzekutimi i Titullit Ekzekutiv, ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm dhe për rrjedhojë, për ekzekutimin e tij, duhet të kryhet vendosja e masës së bllokimit të subjektit në emër të palës debitore, dorëzanëse ose pala e tretë (sipas rastit).

Për këtë arsye, në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

Përsa më sipër, në referim të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 10031, Datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ:

1. Qendra Kombetare Biznesit, të bëjë bllokimin e subjektit, në emër të: Shoqeria Ujesjellesi Berat-Kuçove Me Nipt J62903166T për Ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv.
2. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm të subjektit në emër të debitorit të përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive.
4. Dokumentacioni i subjektit në Qendrën Kombëtare Biznesit do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga ana jonë.
5. Ky urdhër u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

ZYRË E PËRMBARIMIT PRIVAT "616/A "

PËRMBARUESI GJYQËSOR

AUREL MATO

